

**AKT – THEMELIMI**

**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**«KOMITETI GJIROKASTER» shpk**

Sot më datë 08.05.2022, ne ortaket e shoqërisë:

**Arbër Çepani**, atësia Çlirim, amësia Evgjeni, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Myslym Shyri; ND. 75; H. 41; Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7 1023; Tiranë, lindur më 08/05/1987, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilët u garantova me Leternjoftim ID nr. 03151281 dhe nr. Personal I70508090S, mbështetur : Në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqërite tregtare” Të Plotësuar, Në ligjin “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ka themeluar një Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar me emertimin **“KOMITETI GJIROKASTËR” shpk**, (me poshtë e quajtur “Shoqëria”)

**KREU I**

**Neni 1**

**Krijimi**

Shoqeria **“KOMITETI GJIROKASTËR” shpk**, është person juridik I të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria **“KOMITETI GJIROKASTËR” shpk**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortakët”, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri ne pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortakët gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesët im me kontributin që kanë dhënë në kapital.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka selinë në Gjirokastër, Rruga e Zejtareve - Pazari Gjirokastër, Zona kадестrale 8542, Pasuria Nr 8/50-N7, Gjirokastër. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, dhe të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filial, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakëve.

**Neni 4**

**Objekti i veprimtarisë.**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitet privat si më poshtë:

Ngritje dhe administrim i bareve, restoranteve, hotelerive, si dhe aktivitete të tjera ndihmuese të ndërvarura apo në funksion të aktivitetit të mësipërm.



**Neni 5**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhe kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKR.

**KREU II**  
**KAPITALI**  
**Neni 6**  
**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është ; 100.000 lekë e përbërë nga 1 kuotë e zotëruar nga Ortaku:

**Z. Arbër Çepani**, zotëron 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 lekë, që i korrenspondon 100% të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga "ortakët" e shoqërisë.

**-Z. Arbër Çepani** është administrator i shoqërisë "**KOMITETI GJIROKASTËR**".

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortakët përgjigen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë;

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:


- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në astin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**  
**Neni 8**

Organi Vendimmarrës Ortakët janë organ i vetëm vendimmarrës i shoqërisë. Ortakët janë organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.



Çdo ndryshim statute duhet të depozitohet pranë QKB-se për të pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë. Ortakët, vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtarë të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
- dh) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë; Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
  - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe mbulimin e humbjeve
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 9** Administrimi


Administrator i shoqërisë ështe **Z. Eni Kaçi** lindur më 26.07.1991 ne Gjirokastër , mbajtës I ID J10726102W, letërnjoftim 034019920.

Data e fillimit të administratorit ështa data e regjistrimit të shoqërisë ne QKB. Administrator i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 3 vjeçar me të drejtë ripërtëritje. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakëve të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

#### **Neni 10** Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një system paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe ne rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çerifikuara, Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem e të jashtëzakonshem.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private, vendas apo tëë huaj, autoriteteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij. Shoëqria nuk merr përsipër pasojet ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është më provë e mjaftueshme.

#### **Neni 11 Viti Financiar**


Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

#### **Neni 12**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;
  - b) me vendim të ortakëve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç)nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtarë për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".



**Neni 13**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në perputhje të plotë me këtë statut dhe disopzitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specific në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplarë në gjuhën shqipe me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare «**KOMITETI GJIROKASTER**» shpk nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale, ortaku i shoqërisë.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**  
**«KOMITETI GJIROKASTER» shpk**

z.Arbër Çepani

